



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE

Legjislatura e –III-
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 12.5.2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi , Naser Rugova , Njomza Emini, Fatmir Rexhepi, Đezair Murati, Nait Hasani, Branisllav Grbić, Hydajet Hyseni,

Munguan: Sabri Hamiti, Lutfi Haziri dhe Edita Tahiri

Në mbledhje morën pjesë nga Agjensioni për integrime evropiane Sebiha Shala dhe Filloreta Kabashi

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit : Minire Hasani dhe Ahtere Loxha,.

Pjesëmarrsit tjerë: Shaqir Mala Avni Zuka NDI, Ermal Krasniqi NDI, Blerim Vela, OSCE, Agron Demi Instituti GAP, Lejla Selimi OSCE , Fitore Zeneli KDI

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi kryetare e Komisionit me këtë :

Rend Dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 14. 04.2008,**
- 3. Diskutim lidhur me udhëtimin zyrtar në Bruksel.**
- 4. Shqyrtimi i P/ligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

5. **Shqyrtimi i P/ligjit për sigurinë private , nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE**
6. **Shqyrtimi i P/ligjit për sponzorimet në kulturë, rini dhe sporte nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE**
7. **Shqyrtimi i P/ligjit për ndërmjetësimin nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE**

1. Rendi i ditës u miratua .

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 14. 04.2008,

Procesverbali u miratua pa vërejtje

Zylfije Hundozi kaloi në pikën e radhës .

3. Diskutim lidhur me udhëtimin zyrtar në Bruksel.

Lidhur me këtë tha se i kishte bërë kërkesë Kryesisë së Kuvendit për realizimin e vizitës në parlamentin Evropian me dt 28 dhe 29 Maj .Kërkesa i është bërë Kryesisë dhe presim vendimin se a do të shkoj i tërë komisioni apo vetëm disa., andaj propozoj ndarjen e temave në mënyrë që të fillojnë përgatitjet me kohë.

Ajo tha se kam kërkuar me email nga Parlamenti Evropian me na ndihmuar, mirëpo ata më thanë se ata i sponzorojnë dy vizitat tjera të Kuvendit, andaj mendoj se Kryesia e Kuvendit duhet të i heq shpenzimet për tërë komisionin ,në vazhdim njoftoi për agjendën e kësaj vizite e cila kishte këto pika.

1. Situata politike në Kosovë dhe shkëmbimi i qëndrimeve me Parlamentin Evropian dhe si mundet Bashkësia ndërkombëtare me i ndihmuar Kosovës.
2. Presentimi i Kushtetutës përparimet e arritura në implementimin e standardeve dhe pozita e minoriteteve.
3. Lufta kundër korrupsionit dhe krimin.
4. Situata ekonomike në Kosovë dhe shkëmbimi i ideve në opsionet e ndryshme politike.
5. Politikat e Qeveris së Kosovës dhe sfidat në fushën e edukimit
6. Deklarata e përbashkët
7. Të ndryshme

Kërkoj nga anëtarët të vendosin se cilat tema do ti marrin dhe lidhur me këtë hapi diskutimin.

Hydajet Hyseni e pëlqen nismën që me kohë të fillohen përgatitjet, por mendon se do duhej pritur se cili prej anëtarëve do të shkoj e pastaj të ndahen temat, sepse konsideron se mjaftonë një javë apo 10 ditë për ti bërë përgatitjet.

Pastaj tha se nuk e kishte të qartë pasqyrën e aktiviteteve, sepse teksti i shpërndarë ishte i mangët dhe jo i plotë, andaj propozoj që në mbledhjen e ardhshme do ta kemi përbërjen e plotë se kush do të shkoj dhe pastaj do ti ndajmë temat.

Naser Rugova po ashtu mendon se së pari të caktohet përbërja e delegacionit e pastaj të caktohen temat, sepse vlerëson se kur bëhen ftesa të nivelit ndërkombëtar dhe komisioni e përfaqëson parlamentin e Kosovës ,duhet bërë përgaditjet e nevojshme me kohë që atje të paraqitemi si na ka hije. Temat janë të ndryshme dhe specifike, tha se ne duhet të paraqesim një qasje shumë serioze dhe realitetin e zhvillimeve progresive në Kosovë . Kërkoj të fillohet me procedurat e vizave në zyrën diplomatike dhe të shkohet zyrtarisht në emër të komisionit dhe të kërkohet që i tërë komisioni të pajiset me viza Shengen një vjeçare.

Kryetarja vlerësoj se pa marr parasysh se sa veta shkojnë, tha se është agjenda dhe nga sot të mendoni se cilën temë do ta merrni dhe të caktojme një ditë kur me u taku . Kurse sa i përket vizave kah lehtësira sepse tani vizat po i japin në Prishtinë në Zyrën Belge.

Lidhur me këtë u nxorr ky:

Përfundim

Komisioni të takohet edhe një herë pasi Kryesia të vendos se sa anëtar të Komisionit do të shkojnë në parlamentin Evropian në Bruksel, si dhe të ndahen temat për ti përgatit .

Kryetarja njoftoj se komisioni do të filloj me shqyrtimin e projektligjeve nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe tha se komisioni ynë disa ligje nuk ka nevojë të i shqyrtoj nga ky aspekt siç është Projektligji për ansamblin shota dhe disa ligje tjera që nuk kanë të bëjnë me Aquis Communitare,sepse janë ligje nacionale dhe varet prej shtetit se a do ti sponzoroj apo jo dhe është marrëveshje me agjensionin për përpunimin e ligjeve

Ajo pastaj kaloi në pikën e radhës

4. Shqyrtimi i P/ligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Zylfije Hundozi tha se ky Projektligj nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së është përpunuar nga zyra për Integritet evropiane ,na janë dhënë shpjegimet dhe i kemi raportet e gatshme. Nga përvoja nga dy mandatet e kaluara i kemi caktuar për çdo projektligj nga një raportues i cili e ka shqyrtuar ligjin dhe i ka përgatit amendamentet dhe i ka paraqit në komision ku pastaj komisioni i ka korrigjuar dhe ka nxjerr përfundimin, andaj mendoj se edhe në këtë mandat të caktohet raportuesi.

Projektligjet që janë në shqyrtim janë gati me rekomandime ,por duhet të caktohet një raportues i cili do të ulet me stafin dhe ta përpiloj një përfundim ,pyeti se kush do të jetë raportues .

Hydajet Hyseni përshëndeti nismën e komisionit që ti shqyrtoj projektligjet nga fusha që mbulon dhe ideja që të angazhohen raportuesit është e mirë , por tha se raportuesi sipas rendit mund të bëjë raport, kur ka materie dhe nëse bëhet grupi punues atëherë raportuesi duhet ti ndihmoj komisionit dhe të raportoj.

Në vazhdim ngriti 2 çështje për diskutim.

1. Konsideroj se duhet të bashkëpunoj komisioni me Agjensionin për integritet, por mendon se duhet të ekzistoj një standardizimi i deklaratave të agjensionit, i cili do ti ndihmoj shumë edhe komisionit edhe vetë Agjensionit ,sepse tha se shpesh herë në ligje, hasim në deklaratën me formulime të ndryshme p.sh thuhet se, mund të konfirmohet se nuk janë në kundërshtim me Aquis communitare , konsideroj se fjala “mund të “nuk shkon në gjuhën juridike . Sa i përket këtyre projektligjeve tha se nuk kishte pas kohë ti krahasoj me aquis communitare dhe ne nuk kemi pas mundësi ta bëjmë një hulumtim të pa varur prandaj partnerët tanë të cilët bashkëpunojnë me ne duke përfshi Agjensionin për integritet evropiane mund të na sugjerojnë që brenda vlerësimeve të tyre, ne të bëjmë sugjerime eventuale dhe amendamente eventuale.
2. Do të ishte mirë që ekspertiza në komision të institucionalizohet me ekspert ndërkombëtar dhe vendor në mënyrë që ekspertët ta informojnë komisionin me ekspertiza profesionale për secilin ligj ..

Sebiha Shala tha se sa i përket këtij ligji dhe këtyre katër Pr/ligjeve që janë në procedurë nuk i cenonë parimet e Aquis communitaire. Ka pas komente më herët pse secili Projektligj që vjen në parlament nuk i cenonë parimet e BE-së . Ne si Agjension i shikojmë së pari projektligjet dhe nëse konstatojmë se i cenonë parimet e aquis communitaire, ia kthejmë ministrisë dhe pastaj ata çdo rekomandim tonin duhet ta marrin parasysh ,d.m.th as në Qeveri dhe as në Parlament nuk guxon me ardh asnjë ligj që i cenon këto parime. Në bashkëpunim me Komisionin për integritet në bazë të agjendës së Parlamentit se cilat ligje do të shqyrtohen , ne i marrim ato ligje dhe ne si agjenci mund të ju dërgojmë opinionet ligjore që përmbajnë rekomandimet, stafi mbështetës në bashkëpunim me ne ta formoj një dokument dhe me ju informua se cilat pika ndërliken me aquis communitaire. dhe nuk ka nevojë me i shikua direktivat ,pastaj në seancë ju e keni rolin që ti mbrojnë ato pika.

Zylfije Hondozi vlerësoi se për secilin ligj që komisioni duhet ta shqyrtoj, të caktohet raportuesi dhe pastaj në komision tha ne ti japim vërejtjet tona dhe ti japim amendamentet tona dhe në këtë mënyrë të punoj komisioni në bashkëpunim me Agjensionin, ,sepse ne nuk mund ti shikojmë direktivat sepse nuk jemi ekspert edhe pse kam kërkuar ekspert nga UNDP, por deri më tani nuk kam marr përgjigje. Kurse sa i përket këtij projektligji dhe projektligjeve që janë sot në rend dite janë të gatshme me rekomandime .

Pas diskutimeve të bëra u nxor ky:

Përfundim

Komisioni me shumicë votash konstaton se P/ligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Shqyrtimi i P/ligjit për sigurinë private , nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE

Kryetarja tha se edhe për këtë projektligj nga Agjensioni evropian për integritet ka ardhë opinioni ligjor dhe rekomandimi, andaj hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur projektligji u hodh në votim .
Pas votimit u nxor ky;

Përfundim

Komisioni me shumicë votash konstaton se P/ligji për sigurinë private, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

6. Shqyrtimi i P/ligjit për sponsorimet në kulturë, rini dhe sporte nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE

Kryetarja hapi diskutimin duke njoftuar se edhe për këtë projektligj është opinioni ligjor dhe rekomandimi prej Agjencisë për Integritet Evropian.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur projektligji u hodh në votim .

Pas votimit u nxor ky:

Përfundim

Komisioni me shumicë votash konstaton se P/ligji për sponsorimet në kulturë, rini dhe sporte , nuk cenon parimet e Acquis communautaire

Kryetarja hapi diskutimin lidhur me pikën e radhës

6. Projektligji për ndërmjetësimin nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur e hodhi në votim projektligjin

Pas votimit u nxor ky:

Përfundim

Komisioni me shumicë votash konstaton se P/ligji për „nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

Të ndryshme

Pasi që **Xhezair Murati** është anëtar i Kryesisë erdhi me vonesë në mbledhje të Komisionit sepse kishte marr pjesë në mbledhje të Kryesisë në të cilën ishte shqyrtuar kërkesa e komisionit për të udhëtuar në Bruksel.

Andaj Kryetarja e Komisionit kërkon nga ai që lidhur me këtë ta njoftoj komisionin se çka ka vendos Kryesia.

Xhezair Murati tha se në Kryesi ishte shqyrtuar kërkesa lidhur me vizitën në Bruksel dhe anëtarët e Kryesisë kishin mendime dhe qëndrime të ndryshme rreth asaj se a duhet për të udhëtuar komisioni në përbërje të plotë apo jo . Unë si anëtarë i Kryesisë kamë thënë se Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Mardhënie me jashtë janë nyje kryesore për lidhje me Evropën dhe këto Komisione gjithnjë duhet të udhëtojnë në përbërje të plotë. Në fund Kryesia kishte marrë qëndrim që Komisioni ta realizoj vizitën në Bruksel me dt. 28 dhe 29 maj, por jo në përbërje të plotë por nga një përfaqësues nga secili Grup parlamentar.

Duke e pas parasysh rëndësinë e Komisionit kishte pakënaqësi nga anëtarët, pse nuk është miratua kërkesa që të udhëtojë i tërë komisioni në Bruksel , andaj i propozuan Kryetares së komisionit të shkojë tek Kryetari i parlamentit dhe të kërkojë që të shkojë i tërë komisioni në Bruksel dhe autorizohet administrata që së bashku me shërbimin e deputetëve të fillojnë procedurat e organizimit .

Kryetarja në vazhdim njoftoi se Instituti për zhvillime të qëndrueshme ka bërë kërkesë për nënshkrimin e një Memorandum bashkëpunimi me Komisionin për Integritet Evropian , për ti ofruar ndihmë Komisionit në ligje. Deri më tani tha se kemi nënshkruar memorandum me NDI dhe GAP. Andaj pyeti anëtarët se a pajtohen që ta nënshkruaj edhe këtë memorandum.

Naser Rrugova konsideron se është e domosdoshme mbështetja institucionale për Komisionin ku po shihet edhe gatishmëria. Por tha se ne kemi nevojë të mbështetemi me ekspert të politikave sektoriale, sepse neve na vijnë ligje nga të gjitha fushat. Jam për atë që të kyçim ekspert vendor që kanë përgaditje profesionale dhe të formojmë një Projekt që ti angazhojmë këta njerëz të ri të cilët janë shkolluar jashtë dhe me gjet mënyrën të jenë në lidhje të përhershme me Parlamentin dhe Komisionin tonë dhe ta ndihmojnë Komisionin më të ri dhe shumë të rëndësishëm.

Zylfije Hondozi tha se e kishte fut edhe një klauzull në memorandum dhe në momentin kur ata nuk bashkëpunojnë me komisionin dhe nuk na ndihmojnë atëherë e ndërrprejmë memorandum.

Hydajet Hyseni vlerësoi se në procesin e ndërtimit të raporteve të bashkëpunimit me shoqërinë civile , tha se së pari duhet ta kemi një pasqyrë dhe koncept se cilët janë partnerët . E shoh të nevojshme këtë ndihmesë, por në kuadër të një koncepti.

Branislav Grbiç tha se ky komision ka një detyrë të rëndësishme për Kosovën ,që është harmonizimi i legjislacionit me at të BE-së . Komisioni vetë nuk mund ta bëjë këtë por neve na duhet përvoja me njerëzit që kanë përvojë në këtë drejtim .Andaj ne duhet të kontaktojmë me Zyrat dhe në çdo mbledhje të ftojmë nga një anëtar të zyrës së cilit do shtet që janë këtu dhe kur bëhet fjalë për udhëtime siç është rasti i sotëm, a të shkoj i tërë komisioni apo jo , atëherë duhet vënë kontakt me këto zyra dhe në kuadër të këtyre zyrave të formojmë grupe të vogla prej dy ose 3 njerëzve të shkojnë nëpër shtete të ndryshme dhe ato përvoja pastaj ti bartin në Komision, mendoj se kjo është variant më e mirë se të shkoj në një shtet i tërë komisioni.

Komisioni përfundoi punimet në orën 12,00 min.

Procesverbalin e hartoj

Ahtere Loxha

Kryetarja e Komisionit

Zylfije Hundozi

